



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

Agjencia e Kosovës për Akreditim
Agencija Kosova za Akreditaciju
Kosovo Accreditation Agency



Plani Strategjik i Agjencisë së Kosovës për Akreditim
2021-2025

Përmbajtja

Hyrje	3
Fjalë nga Drejtori i AKA-së	4
Konteksti i AKA-së.....	5
Misioni, vizioni dhe qëllimet e AKA-së.....	8
Objektivat Strategjike të AKA-së.....	9
Plani i implementimit dhe monitorimi	16

Hyrje

Plani Strategjik 2021-2025 i AKA-së është dokument bazë i cili do të përcaktojë orientimin dhe drejtimin e proceseve të sigurimit të cilësisë në sektorin e arsimit të lartë për 5 vitet e ardhshme.

Ky Plan është hartuar në përputhje me misionin e AKA-së i cili ka shërbyer si udhërrëfyes për vendosjen e objektivave strategjike të cilat mundësojnë vlerësimin e vazhdueshëm të efektivitetit të veprimeve të AKA-së. Gjithashtu ky Plan është hartuar duke marrë për bazë parimet e aplikuara në Zonën Evropiane të Sigurimit të Cilësisë (EHEA), posaçërisht Standardet dhe Udhëzuesit Evropian të Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë (ESG 2015) si dhe rekomandimet e vlerësuesve të jashtëm të ENQA.

Plani Strategjik është hartuar në bazë të një procesi të gjerë konsultativ i cili ka përfshirë gjithë pjesëtarët relevantë të arsimit të lartë në Kosovë. Përmes qasjes gjithëpërfshirëse në këtë proces, AKA ka siguruar që objektivat strategjike të jenë në përputhje me kërkesat dhe nevojat e sistemit të arsimit të lartë në Kosovë dhe të jenë të përshtatshme për kontekstin brenda të cilit zhvillohet sistemi jonë i sigurimit të cilësisë.

Kontributi i të gjithë akterëve për hartimin e këtij Plani Strategjik është tregues i rritjes së përkushtimit të të gjithë komunitetit akademik për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së arsimit të lartë në Republikën e Kosovës.

Fjalë nga Drejtori i AKA-së, Naim Gashi

Sistemi i sigurimit të cilësisë në sektorin e arsimit të lartë është duke u zhvilluar vazhdimisht. Rritja e mobilitetit të studentëve dhe stafit akademik domosdoshmërisht kërkon që cilësia e gradave akademike të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë në Kosovë të jetë e krahasueshme dhe e barabartë me cilësinë e gradave akademike të ofruara nga universiteteve evropiane.

AKA si rregullator i sistemit të sigurimit të cilësisë në Kosovë bartë përgjegjësinë kryesore që cilësia e diplomave të studentëve tanë të jetë në atë nivel që t'iu mundësojë atyre kompetencë të plotë në tregun vendor apo ndërkombëtar të punës. Andaj është detyrë e AKA-së që të sigurojë se institucionet tona të arsimit të lartë aplikojnë metodat më bashkëkohore të mësimdhënies dhe hulumtimit përmes kuadrove të specializuara akademike dhe shkencore në përputhje me standardet e aplikuara gjerësisht nga universitetet evropiane.

Ne do të jemi aty për të siguruar besimin e ndërsjellë në mes të studentëve, stafit akademik, institucioneve të arsimit të lartë por edhe shoqërisë në përgjithësi, përmes aplikimit të procedurave transparente, kredibile dhe cilësore të sigurimit të jashtëm të cilësisë, sikurse akreditimi dhe monitorimi. Ne si Agjenci do të jemi të përkushtuar që të promovojmë parimet e qeverisjes së mirë, posaçërisht të transparencës dhe llogaridhënies, si dhe zgjerimin e cilësisë në çdo veprimtari të institucioneve të arsimit të lartë, në mënyrë që Kosova të vendoset në hartën e Zonës Evropiane të Arsimit të Lartë dhe shumë shpejtë të rikthejë anëtarësimin e saj në ENQA dhe EQAR.

Konteksti i AKA-së

Sistemi i sigurimit të jashtëm të cilësisë në Kosovë karakterizohet me specifika të përafërta sikurse shtetet evropiane të cilat kanë kaluar në procesin e tranzicionit, sikurse rritja e pakontrolluar e institucioneve të arsimit të lartë, mungesa e mekanizmave të sigurimit të brendshëm të cilësisë si dhe politika jo të qarta për zhvillimin e kuadrove akademike dhe shkencore.

Vendosja e mekanizmit të akreditimit kishte për qëllim aplikimin e një sistemi të sigurimit së cilësisë ndaj institucioneve të arsimit të lartë si dhe rritjen e transparencës së institucioneve karshi studentëve dhe shoqërisë në përgjithësi. Me gjithë sfidat nga faktorët e jashtëm por edhe faktorëve të brendshëm, sikurse resurset e limituara njerëzore si dhe ndryshimet e shpeshta të menaxhmentit të AKA-së, AKA ka arritur që përgjatë 10 viteve të funksionimit, të vendosë një standard të cilësisë i cili ka qenë i krahasueshëm me shtetet e Evropës qendrore dhe lindore. AKA-ja ka arritur me sukses të jetë pjesë e mekanizmave kryesor evropian të sigurimit të cilësisë si dhe ka qenë pjesë aktive e gjitha ngjarjeve të rëndësishme për proceset e sigurimit të jashtëm të cilësisë në Evropë.

Megjithëse janë bërë 10 vjet që nga aplikimi i procesit të akreditimit, AKA-ja ka reflektuar për ndikimin që procesi i akreditimit ka pasur në rritjen e cilësisë së arsimit të lartë në Kosovë. Në dy vitet e fundit AKA-ja ka rishikuar Standardet e Akreditimit, proces i cili ka ndodhur si përgjigje ndaj kërkesave dhe nevojave në ndryshim të institucioneve të arsimit të lartë por edhe tërë sistemit në përgjithësi. Tashmë Standardet e Akreditimit kanë për qëllim të konsolidojnë sistemin e brendshëm të cilësisë së institucioneve të arsimit të lartë si dhe të mbështesin IAL-të e Kosovës në zgjerimin e cilësisë dhe zhvillimin e vazhdueshëm të operacioneve të tyre. Në bazë të rezultateve të proceseve të akreditimit, është evidente që institucionet e arsimit të lartë janë duke bërë përpjekje serioze në drejtim të mirëmbajtjes së kritereve të cilësisë duke dëshmuar pjekuri institucionale e cila doemos ndikon në përmirësimin e jetës studentore dhe cilësinë e kompetencave të tyre.

Në përputhje me zhvillimet dhe rrethanat të cilat afektojnë zhvillimin dhe proceset e udhëhequra nga Agjencia e Kosovës për Akreditim, janë identifikuar edhe nevojat të cilat duhet të plotësohen për të siguruar se misioni i AKA-së është duke u përmbushur në vazhdimësi. Hartimi i legjislacionit të veçantë të AKA-së, funksionalizimi i procedurave të monitorimit, rritja e resurseve humane, rritja e bashkëpunimit me komunitetin akademik sikurse IAL-të, studentët, punëdhënësit, etj. janë disa prej komponentëve për të cilat

AKA duhet të angazhohet në pesë vitet e ardhshme. Këto komponenta përpos që kanë për qëllim përmbushjen e kritereve formale të cilat do të mundësojnë kthimin e AKA-së në ENQA dhe EQAR, përfundimisht kanë për qëllim që të ndryshojnë qasjen e AKA-së nga sistemi i sigurimit të cilësisë tek një qasje mbështetëse ndaj IAL-ve me qëllim të zgjerimit të cilësisë.

Për vendosjen e objektivave strategjike të cilat avancojnë punën e AKA-së dhe të cilat rrisin cilësinë e proceseve të sigurimit të jashtëm të cilësisë, AKA ka aplikuar një qasje të identifikimit të nevojave dhe kërkesave bazuar në të dhëna dhe dëshmi. Në vijim është paraqitur SWOT analiza e hartuar nga grupi punues i cili ka analizuar përparësitë, dobësitë, mundësitë dhe rreziqet e AKA-së, si dhe të dhënat në dispozicion për të arritur deri të vendosja e objektivave të cilat janë të përshtatshme për qëllimin e AKA-së.

Përparësitë
<ul style="list-style-type: none"> - Korniza e sigurimit të cilësisë e AKA-së është në përputhje me parimet e përcaktuara nga Standardet dhe Udhëzimet ESG 2015; - Pavarësia e vendimmarrjes së KSHC-së garantohet përmes Ligjit për AL dhe UA për Akreditim; - AKA si mekanizmi kryesor për sigurimin e cilësisë në AL gëzon mbështetje nga studentët, shoqëria, donatorët dhe akterët e tjerë përkatës; - Mbështetja profesionale dhe financiare nga donatorët ndërkombëtarë; - Vlerësimet për akreditim kryhen vetëm me ekspertë ndërkombëtarë të akreditimit; - Standardet e vlerësimit të AKA-së marrin parasysh kërkesat e Kornizës Kombëtare të Kualifikimeve, e cila i referohet Kornizës Evropiane të Kualifikimeve; - AKA përfshin në procesin e akreditimit ekspertë studentë nga Unioni Evropian i Studentëve; - Staf administrativ i përkushtuar dhe me përvojë; - Staf i profesional i trajnuar për procese të sigurimit të jashtëm të cilësisë; - AKA posedon rregullativën e brendshme për sigurimin e cilësisë; - AKA merr pjesë rregullisht në ngjarje ndërkombëtare; - AKA gëzon marrëdhënie të mira me agjencitë që janë anëtare të ENQA dhe agjenci të tjera në rajon; - AKA është transparente ndaj publikut, publikon raportet e plota të ekspertëve, vendimet, njoftimet dhe informacionet e tjera në lidhje me procesin e akreditimit; - Mbledhjet e KSHC-së janë transparente dhe monitorohen nga shoqëria civile; - AKA ka digjitalizuar pjesërisht procesin e akreditimit përmes platformës “e-akreditimi”; - Arsimi i lartë ka përparuar më tej përmes krijimit të organeve konsultative, të tilla si Konferenca e Rektorëve dhe Unioni i Studentëve; - AKA ka kontribuar në forcimin e kontributit të studentëve në vendimmarrje; - AKA ka mbështetur gjithnjë e më shumë IAL duke u ofruar atyre trajnime në çështjet e sigurimit të cilësisë.

Dobësitë
<ul style="list-style-type: none"> - Mungesa e Ligjit të AKA-së; - Të kuptuarit e akreditimit si qasje kontrolli dhe jo si qasje mbështetëse për IAL-të; - Largimi nga ENQA;

- Largimi nga EQAR;
- Mungesa e procedurave pas akredituese dhe procedurave të monitorimit;
- Pamjaftueshmëria e burimeve njerëzore për të verifikuar plotësisht përmbushjen e standardeve të akreditimit;
- Burimet e pamjaftueshme njerëzore për ekzekutimin e aktiviteteve të përditshme;
- Standardet e akreditimit janë të peshuara njëllë dhe nuk ka dallim mes tyre;
- Mungesa e standardeve të akreditimit për fusha të rregulluara të studimit;
- Studentët nuk janë të përfshirë mjaftueshëm në aktivitetet e AKA-së;
- Punëdhënësit nuk janë të përfshirë në aktivitetet e AKA-së;
- Hapësira fizike të kufizuara për AKA-në.

Mundësitë

- Miratimi i Ligjit të AKA-së;
- Kthimi i Kosovës në EQAR dhe ENQA;
- Rritja e numrit të stafit administrativ profesional dhe kompetent;
- Krijimi i grupeve vendore të ekspertëve;
- Bashkëpunimi me agjenci evropiane të akreditimit për kryerjen e proceseve të vlerësimit;
- Vetëdijesimi i komunitetit akademik për rolin e sigurimit të cilësisë në arsimin e lartë;
- Rritja e bashkëpunimit me organizatat e shoqërisë civile dhe palët e tjera të interesit;
- Rritja e bashkëpunimit me institucionet lokale për të informuar debatin në lidhje me marrëdhëniet midis programeve të studimit dhe tregut të punës;
- Modernizimi i arsimit të lartë përmes procesit të akreditimit;
- Digjitalizimi i tërësishëm i procesit të akreditimit;
- Ndërkombëtarizimi i arsimit të lartë të Kosovës përmes procesit të akreditimit;
- Rritja e bashkëpunimit rajonal në fushën e shkëmbimit të informatave;
- Avancimi i standardeve të akreditimit që mundësojnë integrimin e IAL-ve në projektet Erasmus, Erasmus +;
- Integrimi i Kosovës në Procesin e Bolonjës;
- Integrimi i sistemit të arsimit të lartë të Kosovës në Zonën Evropiane të Kërkimit;
- Përpilimi i analizave vjetore tematike;
- Ndërlidhja më e fortë e sistemit të arsimit me tregun e punës;
- Krijimi i një sistemi të centralizuar të AKA-së që ofron të dhëna për nevojat e tregut;
- Vendosja e AKA-së në objektin e ri për rritjen e performacës së stafit dhe përmirësimit të shërbimeve.

Rreziqet

- Dëmtimi i reputacionit si pasojë e ndërhyrjeve politike në pavarësinë e AKA-së;
- Zhvillimi i ngadaltë ekonomik mund të reflektojë në cilësinë e programeve të ofruara të studimit;
- Mungesa e kushteve të pranueshme të punës në IAL të Kosovës, gjë që e çon personelin akademik të kërkojë mundësi më të mira jashtë vendit;
- Infrastruktura joadekuate për të mbështetur programet e studimit, përfshirë bibliotekat dhe laboratorët;
- Mungesa e vetëdijes së IAL-ve për mundësitë për investime në inovacion, kërkime dhe shkencë;
- Një tendencë për të ofruar programe akademike për të cilat ka personel të pamjaftueshëm akademik.

Misioni, vizioni dhe qëllimet e AKA-së

Agjencia e Kosovës për Akreditim (AKA) është agjenci e pavarur përgjegjëse për vlerësimin e jashtëm (akreditimin, riakreditimin, validimin dhe monitorimin) të institucioneve të arsimit të lartë në Kosovës.

Misioni i AKA-së është:

Të mbështesë zhvillimin e cilësisë në institucionet e arsimit të lartë përmes procesit të vlerësimit të jashtëm dhe të sigurojë shoqërinë e Kosovës se cilësia e arsimit të lartë është në nivelin e standardeve ndërkombëtare.

Qëllimet e Agjencisë së Kosovës për Akreditim (AKA) janë:

- të promovojë, përmirësoj dhe rrisë cilësinë e arsimit të lartë;
- të rrisë transparencën dhe llogaridhënien në sistemin e arsimit të lartë;
- të përmirësojë cilësinë e studimeve në institucionet e arsimit të lartë;
- të inkurajoj përmbajtje inovative në arsimin e lartë;
- të sigurojnë krahasueshmërinë e kualifikimeve nga institucionet e arsimit të lartë të Kosovës me ato të dhëna nga programet ndërkombëtare;
- të zbatojë objektivat për integrimin e Kosovës në Zonën Evropiane të Arsimit të Lartë dhe të kontribuojë në zhvillimin e saj.

Vlerat që mbështesin punën e AKA-së janë:

- **Pavarësia** - Vendimet e AKA-së merren në mënyrë të pavarur dhe të arsyetuar në mënyrë të qëndrueshme dhe të verifikueshme;
- **Transparenca** – AKA udhëhiqet nga parimet e përgjegjësisë dhe llogaridhënies publike përmes një politike efektive të informimit;
- **Besueshmëria** – AKA organizon procese kredibile të sigurimit të jashtëm të cilësisë, ku komuniteti akademik dhe shoqëria në përgjithësi beson në punën e AKA-së;
- **Profesionalizmi** – AKA aplikon standarde të larta profesionale të aplikuara në Evropë në proceset e sigurimit të jashtëm të cilësisë.

Objektivat Strategjike të AKA-së

AKA për vendosjen e objektivave strategjike ka bërë vlerësimin e gjendjes aktuale duke identifikuar arritjet kryesore të arsimit të lartë në Kosovë, ka bërë identifikimin e nevojave dhe kërkesave të institucioneve të arsimit të lartë karshi proceseve të sigurimit të jashtëm të cilësisë si dhe ka identifikuar mangësitë të cilat duhet të plotësohen në mënyrë që objektivat strategjike të këtij Plani të jenë sa më të përshtatshme dhe të nxjerrin rezultate. Në këtë drejtim, vendosja e objektivave strategjike, është bërë në bazë të fushave të intervenimit si në vijim:

- ✓ Korniza ligjore
- ✓ Menaxhimi dhe administrimi
- ✓ Sigurimi i jashtëm i cilësisë
- ✓ Digjitalizimi
- ✓ Ndërkombëtarizimi

Objektivi i parë strategjik

“Rikthimi i anëtarësisë së AKA-së në rrjetin evropian të sigurimit të cilësisë ENQA dhe regjistrimi në EQAR”

Objektivi i dytë strategjik

“Kornizë e konsoliduar ligjore që garanton pavarësi institucionale dhe financiare të AKA-së në kryerjen e proceseve të sigurimit të jashtëm të cilësisë”

Objektivi i tretë strategjik

“Sistem i avancuar i menaxhimit dhe administrimit të AKA-së përmes rritjes së kapaciteteve fizike dhe profesionale”

Objektivi i katërt strategjik

“Përmirësimi i cilësisë në sektorin e arsimit të lartë përmes procedurave efikase dhe efektive të akreditimit dhe monitorimit”

Objektivi i pestë strategjik

“Digjitalizimi i avancuar i procedurave të AKA-së për një menaxhim efektiv të informatave dhe të dhënave të procedurave të vlerësimit të jashtëm”

Objektivi i gjashtë strategjik

“Fuqizimi i bashkëpunimit të AKA-së me agjencitë ndërkombëtare të sigurimit të jashtëm të cilësisë”.

OBJEKTIVI I PARË STRATEGJIK

1. "RIKTHIMI I ANËTARËSISË SË AKA-SË NË RRJETIN EVROPIAN TË SIGURIMIT TË CILËSISË ENQA DHE REGJISTRIMI NË EQAR"

Rikthimi i AKA-së në Rrjetin Evropian të Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë (ENQA) si dhe në Regjistrin Evropian të Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë (EQAR) janë dy prioritetet strategjike jo vetëm të AKA-së por edhe të Qeverisë së Kosovës.

Procedurat e vlerësimit të jashtëm të aplikuara nga AKA janë të dizajnuara në atë mënyrë që të sigurojnë përputhshmëri me ESG, mirëpo sipas vlerësimit të jashtëm të ENQA, AKA plotëson pjesërisht disa prej tyre. Në këtë drejtim, AKA ka ndërmarrë veprime dhe procese të cilat synojnë përmbushjen e plotë të standardeve dhe udhëzuesve evropian të sigurimit të cilësisë (ESG) si dhe të rekomandimeve të dhëna nga paneli i vlerësimit të jashtëm nga ENQA.

Masat:

- 1.1. Plotësimi i plotë apo substancial i standardeve dhe udhëzuesve evropian të sigurimit të cilësisë (ESG);
- 1.2. Plotësimi i rekomandimeve të panelit të vlerësimit të jashtëm nga ENQA;
- 1.3. Plotësimi i kërkesave formale për regjistrim në EQAR;
- 1.4. Përforcimi i rolit të AKA-së në sektorin e arsimit të lartë në Kosovë;
- 1.5. Rritja e transparencës së veprimeve të AKA-së dhe ruajtja e besimit në publik.

OBJEKTIVI I DYTË STRATEGJIK

2. "KORNIZË E KONSOLIDUAR LIGJORE QË GARANTON PAVARËSI INSTITUCIONALE DHE FINANCIARE TË AKA-SË NË KRYERJEN E PROCESEVE TË SIGURIMIT TË JASHTËM TË CILËSISË"

Qëllimi parësor i këtij objekti strategjik është hartimi dhe miratimi i Ligjit të Agjencisë së Kosovës për Akreditim (AKA). Pavarësisht që deri më tani kompetencat dhe përgjegjësitë e AKA-së kanë qenë qartësisht të përkrahura në Ligjin e Arsimit të Lartë të Republikës së Kosovës, është konsideruar më se e nevojshme hartimi i ligjit të veçantë i cili do t'i siguronte AKA-së pavarësi të plotë institucionale dhe financiare.

Ligji i veçantë, pamundëson çdo ndërhyrje nga jashtë, përforcon më tepër pozitën e AKA-së në sistemin e arsimit të lartë në Kosovë si dhe mundëson që pavarësia organizative dhe operacionale e AKA-së të ndikojë në përmirësimin e proceseve të sigurimit të jashtëm të cilësisë. Hartimi i legjislacionit të veçantë të AKA-së është gjithashtu kusht për të garantuar para mekanizmave ndërkombëtarë të sigurimit të jashtëm të cilësisë se vendimet e AKA-së janë të pavarura dhe se AKA vepron në mënyrë autonome pa ndikim nga palët e treta.

Masat:

- 2.1. Sigurimi i pavarësisë institucionale, financiare dhe operacionale të AKA-së, përmes Ligjit të AKA-së.
- 2.2. Konsolidimi i akteve nën ligjore të cilat mundësojnë vazhdimësinë e procedurave dhe ruajnë memorien institucionale të AKA-së;
- 2.3. Rritja progresive financiare e AKA-së.

OBJEKTIVI I TRETË STRATEGJIK

3. "SISTEM I AVANCUAR I MENAXHIMIT DHE ADMINISTRIMIT TË AKA-SË PËRMES RITJES SË KAPACITETEVE FIZIKE DHE PROFESIONALE"

Zhvillimi i mekanizmave të sigurimit të brendshëm të cilësisë është njëri ndër prioritetet kryesore të AKA-së për pesë vitet e ardhshme. AKA duhet më tepër të vlerësojë, analizojë dhe të reflektojë për procedurat e brendshme të cilat i aplikon për të siguruar cilësinë dhe integritetin e aktiviteteve të saj. Kjo doemos kërkon rritjen e stafit administrativ si dhe zhvillimin e vazhdueshëm të tyre profesional. Duke qenë se qëllimi i mekanizmave të vlerësimit të jashtëm, ndër të tjera, është rritja e transparencës dhe llogaridhënies, AKA përmes përsosjes së procedurave të brendshme të cilësisë do të avancojë këto dy parime përmes promovimit të vazhdueshëm të tyre përgjatë sektorit të arsimit të lartë. AKA do të zbatojë kriteret e përcaktuara në Manualin për vlerësimin dhe zhvillimin e brendshëm të stafit për të garantuar matjen dhe nxitjen e cilësisë së brendshme.

AKA deri më tani ka shënuar progres në komunikimin me akterët e jashtëm përkatës, sidomos me institucionet e arsimit të lartë dhe studentët. Megjithatë, nevojitet vendosja e mekanizmave dhe instrumenteve formale për mbledhjen e të dhënave nga këta akterë, për të siguruar një konsensus nacional sa i përket sistemit të sigurimit të jashtëm të cilësisë. AKA rekomandohet nga ENQA që të përafrojë komunikimin me punëdhënësit, ndërsa rekomandon përfshirjen aktive të studentëve në menaxhimin e AKA-së por edhe në proceset e vlerësimit të jashtëm.

Masat:

- 3.1. Rritja dhe zhvillimi i vazhdueshëm i AKA-së përmes plotësimit dhe trajnimeve profesionale;
- 3.2. Përforsimi i sigurimit të brendshëm të cilësisë së AKA-së përmes formalizimit të procedurave të brendshme;
- 3.3. Sigurimi i brendshëm i cilësisë përmes fuqizimit të bashkëpunimit me akterë të jashtëm përkatës;
- 3.4. Krijimi i një modeli të vlerësimit të jashtëm për AKA-në.

OBJEKTIVI I KATËRT STRATEGJIK

4. "PËRMIRËSIMI I CILËSISË NË SEKTORIN E ARSIMIT TË LARTË PËRMES PROCEDURAVE EFIKASE DHE EFEKTIVE TË AKREDITIMIT DHE MONITORIMIT"

Pas 10 viteve të vlerësimit të jashtëm të cilësisë, AKA ka arritur që të vendosë një sistem të sigurimit të cilësisë i cili garanton përmbushjen e kriterëve minimale nga institucionet e arsimit të lartë. Meqenëse IAL-të janë duke u pjekur institucionalisht dhe janë duke dëshmuar seriozitet në mirëmbajtjen e kriterëve të cilësisë, AKA do të duhet të ndryshojë qasjen e vlerësimit nga një sistem të sigurimit të cilësisë në sistem të zgjerimit të cilësisë. Kjo nënkupton që dalëngadalë AKA do t'i bëjë IAL-të më përgjegjëse për të siguruar përmbushjen e kriterëve të cilësisë përmes mbështetjes së vazhdueshme dhe trajnimeve profesionale në ndërtimin e një sistemi të qëndrueshëm dhe funksional të sigurimit të brendshëm të cilësisë.

Për të rritur kredibilitetin e proceseve të sigurimit të jashtëm të cilësisë, AKA do të funksionalizojë komponentin e monitorimit dhe të procedurave pas akredituese për të plotësuar hendekun në mes të vizitave të akreditimit tek IAL-të. Procesi i monitorimit dhe procedurave pas akredituese do të garantojë që të gjitha rekomandimet e AKA-së do të zbatohen nga IAL-të. Gjithashtu, procedimi i ankesave nga IAL-të do të konsolidohet përmes aplikimit të procedurave transparente në përputhje me parimet e udhëzuesve evropian të sigurimit të cilësisë.

Për të forcuar kapacitetet e brendshme të garantimit të cilësisë, trajtimit të barabartë të të gjitha IAL-ve dhe eliminimit të burokracisë, AKA-ja në pesë vitet e ardhshme do të digjitalizojë në tërësi procedurat e akreditimit dhe riakreditimit, në mënyrë që ekspertët e jashtëm të kenë qasje në kohë reale tek gjithë dokumentacioni që është subjekt i vlerësimit të jashtëm. Përveç rritjes së cilësisë, digjitalizimi do të rrisë transparencën dhe llogaridhënien tek të gjithë hisedarët në arsimin e lartë në Kosovë.

Masat:

- 4.1. Sigurimi i procedurave efikase dhe efektive të vlerësimit të jashtëm, përmes rishikimit të Manualit të Akreditimit;
- 4.2. Sigurimi i përmbylljes së procesit të ciklit të akreditimit, përmes metodologjisë së monitorimit dhe procedurave pas akredituese;
- 4.3. Rritja e përfshirjes së IAL-ve në politik bërjen e AKA-së, përmes inputeve të vazhdueshme;
- 4.4. Rritja e mbështetjes së IAL-ve nga AKA përmes trajnimeve profesionale, sesioneve informuese, forumeve dhe materialeve informuese.

OBJEKTIVI I PESTË STRATEGJIK

5. "DIGJITALIZIMI I AVANCUAR I PROCEDURAVE TË AKA-SË PËR NJË MENAXHIM EFEKTIV TË INFORMATAVE DHE TË DHËNAVE TË PROCEDURAVE TË VLERËSIMIT TË JASHTËM"

Vendimmarrja e bazuar në dëshmi si dhe planifikimi i ndryshimeve bazohet gjerësisht në të dhëna të besueshme. AKA ka mundësi të shumta për të shfrytëzuar të dhënat në dispozicion. Avancimi i platformave digjitale përpos që mundëson gjenerimin e të dhënave kuantitative të nevojshme për analizat e thella të sistemit, gjithashtu mundëson rritjen e efikasitetit të shërbimeve të AKA-së ndaj IAL-ve dhe studentëve.

Masat:

- 5.1. Sigurimi i proceseve sistematike të menaxhimit të informatave përmes digjitalizimit të procedurave;
- 5.2. Përmirësimi i shërbimeve administrative përmes digjitalizimit;
- 5.3. Digjitalizimi i procesit të vlerësimit të jashtëm, përmes funksionalizimit të plotë të e-Akreditimit;
- 5.4. Përmirësim i komunikimit të AKA-së me institucione përkatëse përmes shfrytëzimit të përbashkët të data bazave.

OBJEKTIVI I GJASHTË STRATEGJIK

6. "FUQIZIMI I BASHKËPUNIMIT TË AKA-SË ME AGJENCITË NDËRKOMBËTARE TË SIGURIMIT TË JASHTËM TË CILËSISË"

AKA synon të jetë në trend me zhvillimet ndërkombëtare të sigurimit të jashtëm të cilësisë. Shumica e agjencive evropiane të sigurimit të cilësisë tani më angazhohen në kryerjen e vlerësimeve përtej kufijve të tyre kombëtar. AKA duhet të angazhohet që të jetë pjesë e këtyre iniciativave dhe të mundësojë ndërkombëtarizimin e arsimit të lartë të Kosovës në Evropë. Përmbushja e rekomandimeve të ENQA dhe EQAR është element i rëndësishëm për AKA-në që Kosova të promovohet në Zonën Evropiane të Arsimit të Lartë (EHEA).

Masat

- 6.1. Aktivitetet e përbashkëta të AKA-së me agjencitë evropiane të sigurimit të cilësisë;
- 6.2. Pjesëmarrja e AKA-së në projekte të përbashkëta me agjenci ndërkombëtare të cilësisë;
- 6.3. Promovimi i sistemit të arsimit të lartë të Kosovës në Evropë.

Plani i implementimit dhe monitorimi

Për të implementuar Planin Strategjik, AKA ka hartuar një kornizë të aktiviteteve të detajuara të cilat përmbajnë afate të qarta kohore si dhe indikatorë të performancës. Objektivat strategjike të këtij plani do të zërthehen në plane konkrete të punës së AKA-së dhe do të jenë pjesë e vlerësimit dhe raportimit të rregullt që AKA-ja do ta realizojë.

Vlerësimi i këtij plani do të bëhet në baza 6 mujore nga Drejtori i AKA-së i cili do të raportojë tek Këshilli Shtetëror i Cilësisë (KSHC) për arritjen e aktiviteteve të planit strategjik. Vlerësimi gjashtë mujor siguron që AKA-ja me kohë do të identifikojë mangësitë apo sfidat në drejtim të realizimit të planit strategjik si dhe të bëjë ndërhyrjet e nevojshme për të siguruar vazhdimësinë e planit.

Plani Strategjik dhe plani i veprimit do të publikohen në ueb faqen institucionale si dhe do t'iu shpërndalet institucioneve të arsimit të lartë, studentëve, donatorëve, ministrive relevante, etj. në mënyrë që të rritet transparenca dhe llogaridhënia e veprimeve të AKA-së ndaj shoqërisë.